



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 375/6 prot

Datë. 29.02.2024

V E N D I M

Nr. 235/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.02.2024 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes së ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-95027-02-12-2024, me objekt: “*Blerje klori*”, me fond limit: 2.520.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale U.K, Dibër Sh.A.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale U.K, Dibër Sh.A.
Lagjja Minatori, Pallati i Kulturës, Bulqizë.

Ankimues: “Albania Distribution Chemicals” SHPK, me NUIS M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të*

Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.02.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-95027-02-12-2024, me objekt: “Blerje klori”, me fond limit: 2.520.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 23.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.A.

II.2. Në datën 15.02.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 375/2024 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3808, e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit si vijon:

“Se pari:

Shtojca 5, Formulari i Specifikimeve Teknike për sa i përket kriterit të sipercituar, tek analizat e kryera nga Instituti i Shendetit Publik, si autoriteti i vetëm përgjegjes për monitorimin e shendetit publik, nuk analizohet Densiteti, PH, dhe Koha e nevojshme e kontaktit > 30 minuta -Turbullira 0.5 NTU (gjeni bashkangjitur analizen e ISHP-se për të qene edhe ju me të qarte). Kjo shtojce bie në kundërshtim me kriterin 2.3.3 dhe mbi të gjitha është e panevojshme. Kërkojme që analiza e paraqitur nga ana jone nga Instituti i Shendetit

Publik, si autoriteti i vetem pergjegjes per monitorimin e shendetit publik, mos perbeje kusht per skualifikim me ato elemente qe ISHP kryen.

Se dyti:

2.3.2 Ofertuesi duhet te paraqese certifikaten e analizes nga Instituti i Shendetit Publik (I.SH.P.), brenda 3 muajve te fundit, per analize toksikologjike per produktet qe prokurohen (Ofertuesi eshte i detyruar ta paraqese dokumentacionin e mesiperme per ato elemente toksikologjike qe realizon I.SH.P.) ose (certifikaten e analizes toksikologjike te produkteve leshuar nga laboratore te akreditur sipas legjislacionit ne fuqi te Republikes te Shqiperise).

Per sa i perket ketij kriteri KPP eshte shprehur disa here, por perseri ne po e perserisim kundershkrimin e ketij kriteri.

Ashtu si edhe GJED ka nenvizuar nder vite, parimi i transparences dhe barazise jane te lidhura ngushte me njera-tjetren, por detyra thelbesore e transparences ne nje procedure prokurimi eshte qe te krijohen kushte dhe rregullat, te hollesishme per te gjitha palet ne proces. Komisioni i Prokurimit Publik ka theksuar, se kriteret e kualifikimit duhet te percaktohen qarte, sakte dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me qellim qe te mos rendojne mbi operatoret ekonomike me kerkesa te teperta dhe te panevojshme, por te fokusohen ne ato kriteret, realizimi i te cilave jep nje informacion mbi operatoret ekonomike dhe siguri autoritetit kontraktor, me qellimin final te permbushjes me sukses te procedures se prokurimit.

Referuar dokumentacionit te procedures se prokurimit, vendosja e kerkeses per certifikaten e analizes nga Instituti i Shendetit Publik (I.SH.P.), brenda 3 muajve te fundit, tek Kapaciteti teknik, pika 2.3.3 kerkese per certifikate analize nga Instituti i shendetit Publik ose nga laboratore te certifikuar, per analize toksikologjike per produktin qe prokurohet (certifikate analize brenda 3 muajve te fundit), nuk i sherben objektit te prokurimit, pasi ne kthim pergjigjen e Institutit te shendetit Publik me nr. 513/1 prot., date 26.05.2023, per kerkesen e bere nga Komisioni i Prokurimit Publik me nr. 963/7 prot., date 18.05.2023, mbi afatin ligjor te vlefshmerise se nje raporti analize, nga ky institucion eshte sqaruar se raporti i analizes ne cdo rast eshte i vlefshem vetem per mostren e sjelle ne ISHP, cka eshte shenuar edhe ne raportin e analizes. Per pasoje kjo kerkese nuk eshte ne perputhje me nenet perkatese: nenet 40 dhe 77 te LPP-se dhe nenit 55 "Procedure e hapur e thjeshtuar" te V.K.M-se nr. 285, date 19.05.2021, "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ku jane percaktuar qarte kriteret e nevojshme ne procedurat e prokurimit per kontratat e mallrave, permbushja e te cilave i jep siguri Autoritetit Kontraktor, qe operatoret ekonomike jane ne gjendje te realizojne me sukses kontraten. Komisioni i Prokurimit Publik ka theksuar, se kriteret e kualifikimit duhet te percaktohen qarte, sakte dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me qellim qe te mos rendojne mbi operatoret ekonomike me kerkesa te teperta dhe te panevojshme, por te fokusohen ne ato kriteret, realizimi i te cilave jep nje informacion mbi operatoret ekonomike dhe siguri autoritetit kontraktor, me qellimin final te permbushjes me sukses te procedures se prokurimit

Se treti:

Ne rast se ofertuesi nuk eshte vete prodhues, duhet te paraqese:

- Autorizim të prodhuesit për ofertuesin ose autorizim për ofertuesin nga distributori i autorizuar prej prodhuesit ose që ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin (ose ekuivalenti i tij/saj) sipas ligjit, përpara noterit. Gjithë këto dokumente duhet të kenë afat vlefshmerie për gjithë kohezgjatjen e kontratës të kësaj procedure prokurimi, i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Ku në rast se autorizimi është leshuar nga distributori duhet të paraqitet edhe Autorizimi/ marrëveshja e bashkëpunimit midis distributorit dhe prodhuesit, e cila duhet të jetë e vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit.

Per sa si perket kriterit të mesipër gjykojmë se: a) Në si operator ekonomik nuk mund të detyrojmë ose të ndikojmë në një marrëveshje dypalëshe mes distributorit të autorizuar dhe prodhuesit që ata të nënshkruajnë përpara noterit, kur këto shoqëri veprojnë jashtë territorit të republikës së shqiptarëve dhe jashtë legjislacionit të tyre. Një marrëveshje tregtare është ligjrisht e vlefshme për sa kohë firmoset dhe vuloset nga dy shoqëri tregtare të cilat kanë përgjegjësi ligjore për gjithçka firmosin dhe vulosin. B) As marrëveshja mes operatorit ekonomik dhe distributorit të autorizuar nuk mund të kërkojë të noterizohet, për sa kohë sipas legjislacionit shqiptar një marrëveshje e lidhur mes dy ose më shumë shoqërive tregtare e cila është firmosur dhe vulosur nga të gjitha palët pjesëmarrëse ka vlerë ligjore, dhe nuk kërkon të noterizohet. Thënë kjo gjykojmë se ky kriter në të dyja rastet është i ekzagjeruar dhe tejkalon kompetencat e AK. Për këtë arsye kërkojmë që kriteri të ndryshohet, duke kërkuar përthimin dhe noterizimin e marrëveshjes së sipër kërkuar. Shembull ashtu si kërkojë në DST nga të gjithë Autoritet Kontraktorë: - Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.”

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 23.02.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 375/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 186/6 prot., datë 21.02.2024, me objekt: “Dërgohet vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave”, bashkëngjitur Vendimi me nr. 186/5 prot., datë 21.02.2024 i KSHA-së, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

II.5. Referuar Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me nr. 186/5 prot., datë 21.02.2024, rezultojnë, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të procedurës së “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-95027-02-12-2024, me objekt: “Blerje klori”, me fond limit: 2.520.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.A, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me nr. 186/5 prot., datë 21.02.2024, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.”

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

III.1.4. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës me nr. 186/6 prot., datë 21.02.2024 të autoritetit kontraktor, me objekt: “Dërgohet vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave”, protokolluar në KPP me nr. 375/3 prot., datë 23.02.2024 dhe Vendimit të KSHA-së me nr. 186/5 prot., datë 21.02.2024, bashkëngjitur kësaj shkrese, KPP-ja konstaton, se autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.A, e ka pranuar tërësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-95027-02-12-2024, me objekt: “Blerje klori”, me fond limit: 2.520.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale U.K Dibër Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

